



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.100/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.Sh “R...” me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1295/19, të datës 19.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1295/19 i datës 19.11.2019, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1295/19 të datës 19.11.2019, është aprovuar kërkesëpapia e paditësit N.T.Sh “R...” me seli në Ferizaj, është anuluar aktvendimi nr.07.3/1164, 1165 i datës 09.12.2015 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit N.T.Sh R... me seli në Ferizaj, t’ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 7,592.37€ (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e tridhjetë e shtatë cent), të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratave Unike Doganore R-16628/047.11.2015 dhe R-16770/10.11.2015 të ZBD Ferizaj.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar ligj, Priset aktgjykimi A.nr.1295/19 i datës 19.11.2019 si i pa bazuar në ligj, të refuzohet padia dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të le në fuqi vendimin e kontestuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore

dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/1164, 1165 të datës 09.12.2015, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.Sh “R...” Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimeve R-16628/07.11.2015 dhe R-16770/10.11.2015 të ZBD Ferizaj.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit N.T.Sh R... me seli në Ferizaj, t’ia kthejë detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 7,592.37€ (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e tridhjetë e shtatë cent), të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratave Unike Doganore R-16628/04.11.2015 dhe R-16770/10.11.2015 të ZBD Ferizaj. Në arsyetimin e aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se nga provat e administruara dhe arsyetimi i vendimit kontestues gjykata nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë në vështirësi të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në asnjë rast e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete se paditësi ia ka paguar eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se vlera e deklaruar me DUD-at kontestues dhe faturat përcjellëse të mallit lëndor A177934/06.11.2016 dhe 083540/04.11.2015 të lëshuara nga eksportuesit. Një vlerësim i tillë i dokumentacionit të mallit nga e paditura me aplikimin e metodës së gjashtë të vlerësimit neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave, është i papranueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Gjykata e konsideron të papranueshëm veprimin e të paditurës që vetëm pse mungon kontrata e shitblerjes dhe deklarata eksportuese, të konsiderohet i papranueshëm i tërë dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor si faturat, pagesat bankare. Nga administrimi i provave gjykata konstaton se paditësi lëndës i ka bashkangjitur edhe kontratën e shitblerjes me eksportuesin “K... –Turqi, e vërtetuar nga të dyja palët kontraktuese, që përmban vlerën e mallit të shitur për kilogram, dhe kontratën e shitjes të datës 12.10.2015 me eksportuesin “P...” Turqi, e vërtetuar nga të dyja palët kontraktuese, e cila kontratë përmban çmimet e mallit të shitur për metër katror. Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura nuk ka mbështetur konstatimin e vet në asnjë dispozitë ligjore që do të përcaktonte se deklarata eksportuese duhet bashkangjitur faturës së malli doganor, për tu aplikuar vlera e transaksionit të mallit konform nenit 33 të kodit Doganor dhe të Akcizave, por duke i anashkaluar dëshmitë mbi pagesën e vlerës së mallit përmes transferit bankar, faturat përcjellëse të mallit, e paditura rivlerëson mallin me metodën e fundit të vlerësimit, e cila duhet përdorur vetëm në rast se mungon dokumentacioni përcjellës i mallit dhe nuk ekzistojnë transaksione identike apo të ngjashme.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i kësaj gjykate e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-at kontestues, si dhe faturat përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që t’i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës provat materiale si faturat e mallit lëndor nr.A177934/06.11.2015 dhe 083540/04.11.2015 të lëshuara nga eksportuesit, kontratat e shitjes të lidhura me eksportuesit, pagesat bankare të datës 16.10.2015 dhe 04.11.2015 të realizuara në BPB, vlera e të cilave përputhet me vlerën e deklaruar të mallit lëndor dhe dokumentacioneve përcjellëse të mallit doganor. Nga këto prova materiale gjykata konstaton se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit dhe përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturave përcjellëse të mallit, pasi që nga transaksionet bankare që dëshmojnë vlerën reale të paguar të mallit lëndor, malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË**

**Dhomat e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.100/22, me datë 10.03.2023**

**Kryetar kolegjit,  
Ramush Bardiqi**